

UDHËZIM
Nr. 20, datë 22. 12. 2003

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 9, DATË 20.09.2003 “MBI PROCEDURËN E
NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE ADMINISTRIMIN E FLETËVE TË VOTIMIT NGA
KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT”, NDRYSHUAR ME UDHËZIMIN NR.18,
DATË 11.10.2003**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29/1, të nenit 109 të ligjit nr 9087, datë 19.6.2003 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

Neni 1

Pas nenit 9 të udhëzimit nr. 9, datë 20.9.2003 “Mbi procedurën e numërimit të votave dhe administrimin e fletëve të votimit nga komisioni i qendrës së votimit”, ndryshuar me udhëzimin nr. 18, datë 11.10.2003, shtohet neni 9/a me përmbajtje si vijon:

“Komisioni i qendrës së votimit do t'i konsiderojë fletët e votimit si të pavlefshme kur vota në të paktën njërin nga pjesët e fletës së votimit është konsideruar e pavlefshme. Fletët e votimit të pavlefshme administrohen nga komisioni i qendrës së votimit, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr.9, datë 20.12.2003.”.

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.